

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41./2014, 53/ 16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit të përqendrimit të parashtruar nga shoqëria aksionare e Ndërmarrjes Publike të Energjisë Elektrike (*Public Power Corporation S.A.*), me seli ne Halkokondili nr. 30 - 104 32 Athinë, Greqi, përmes Andrea Lazarevska, avokate nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 17.05.2023, solli

### AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi që i referohet fitimit të kontrollit të pavarur nga shoqëria aksionare e Ndërmarrjes Publike të Energjisë Elektrike (*Public Power Corporation S.A.*), me seli ne Halkokondili nr. 30 - 104 32 Athinë, Greqi, mbi Enel Grin Pauer Romania D.O.O., me seli në Bukuresht Sektori 3, Bulevardi Mircea Voda, nr. 30, dhoma 4.2, kati 4, Rumani, E-Distribucioni Banat A.D., me seli në Timishoara, rr. Pestaloci, nr. 3-5, Komuna e Timish, Rumani, E-Distribucioni Dobroxhea A.D., me seli në Konstancë, rr. Nikolae Iorga, nr. 89A, Komuna e Konstancës, Rumani, E-Distribucioni Muntenia A.D., me seli në Bukuresht Sektori 3, Bulevardi Mircea Voda, nr. 30, kati 3, Rumani, Enel Enerxhi AD, me seli në Bukuresht, Sektori 3, Bulevardi Mircea Voda, nr. 30, dhoma 6.8, kati 6, Rumani, Enel Enerxhi Muntenia A.D., me seli në Bukuresht Sektori 3, Bulevardi Mircea Voda, nr. 30, dhoma 6.8, kati 6, Rumania, Enel Romania A.D., me seli në Komunën Buftea, Qyteti Buftea, Kalea Bukuresht-Targovishte, nr. 117, Komuna Ilfov, Rumani, Enel EKS Vaj Romania D.O.O., me seli në Bukuresht, Sektori 3, Bulevardi Mircea Voda, nr. 30, dhoma 4,7, kati 4, Rumani, Enel EKS Romania D.O.O., me seli në Bukuresht Sektori 3, Bulevardi Mircea Voda, nr. 30, dhoma 4.11, kati 4, Rumani dhe Enel Trejd Enerxhi D.O.O., me seli në Bukuresht Sektori 3, Bulevardi Mircea Voda, nr. 30, dhoma 7.6, kati 7, Rumani, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative ( Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

## Arsyetim

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, më datën 06.04.2023, e plotësuar më 11.04.2023 dhe më 03.05.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në vijim: Komisioni) është dorëzuar njoftim për përqendrim nga shoqëria aksionare e Ndërmarrjes Publike të Energjisë Elektrike (*Public Power Corporation S.A.*), me seli ne Halkokondili nr. 30 - 104 32 Athinë, Greqi, (në tekstin e mëtejme: JPEEAD), me të cilin JPEEAD do të fitojë kontroll të pavarur mbi: i Enel Grin Pauer Romania D.O.O., me seli në Bukuresht Sektori 3, Bulevardi Mircea Voda, nr. 30, dhoma 4.2, kati 4, Rumani, E-Distribucioni Banat A.D., me seli në Timishoara, rr. Pestaloci, nr. 3-5, Komuna e Timish, Rumani, E-Distribucioni Dobroxhea A.D., me seli në Konstancë, rr. Nikolae Iorga, nr. 89A, Komuna e Konstancës, Rumani, E-Distribucioni Muntenia A.D., me seli në Bukuresht Sektori 3, Bulevardi Mircea Voda, nr. 30, kati 3, Rumani, Enel Enerxhi AD, me seli në Bukuresht, Sektori 3, Bulevardi Mircea Voda, nr. 30, dhoma 6.8, kati 6, Rumani, Enel Enerxhi Muntenia A.D., me seli në Bukuresht Sektori 3, Bulevardi Mircea Voda, nr. 30, dhoma 6.8, kati 6, Rumania, Enel Romania A.D., me seli në Komunën Buftea, Qyteti Buftea, Kalea Bukuresht-Targovishte, nr. 117, Komuna Ilfov, Rumani, Enel EKS Vej Romania D.O.O., me seli në Bukuresht, Sektori 3, Bulevardi Mircea Voda, nr. 30, dhoma 4,7, kati 4, Rumani, Enel EKS Romania D.O.O., me seli në Bukuresht Sektori 3, Bulevardi Mircea Voda, nr. 30, dhoma 4.11, kati 4, Rumani dhe Enel Trejd Enerxhi D.O.O., me seli në Bukuresht Sektori 3, Bulevardi Mircea Voda, nr. 30, dhoma 7.6, kati 7, Rumani.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimet të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

### **Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:**

**JPEEAD** është një shoqëri aksionare greke, një shoqëri aksionare publike në Tregun Kryesor të Bursës së Athinës dhe shoqëria mëmë e Grupit JPEEAD. JPEEAD është prodhuesi dhe furnizuesi kryesor i energjisë elektrike në Greqi. JPEEAD gjithashtu ka 51% të pjesëve në Helenik Distribushn Network Operjtor S.A. e cila zotëron dhe menaxhon rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike në Greqi. JPEEAD operon kryesisht në Greqi, ku ndodhen të gjitha mjetet e saj prodhuese.

JPEEAD zotëron 100% të aksioneve në ENERXHI DELIVERI SOLUSHNS SHA Shkup, me seli në Stoltenbergova 4, objekti 1, B5-1 1/banesa SU nr. 4, Qendër Shkup, Maqedonia e Veriut, me aktivitet të regjistruar të tregtisë me energji elektrike.

Ndërmarrjet mbi të cilat fitohet kontrolli (**Enel Grin Pauer Romania D.O.O., E-Distribucioni Banat A.D., E-Distribucion Dobroxhea A.D., E-Distribucioni Muntenia A.D., Enel Enerxhi A.D., Enel Enerxhi Muntenia A.D., Enel Romania A.D. Romania, Enel EKS Vej Romania D.O.O., , Enel EKS Romania D.O.O., Enel Trejd Enerxhi D.O.O.**), janë aktive në prodhimin e energjisë së rinovueshme, furnizimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike dhe furnizimin me gaz natyror, si dhe shërbime ndihmëse dhe shërbime shtesë dhe produkte dhe shërbime që synojnë lehtësimin e tranzicionit të energjisë në Rumani. Ata janë aktivë vetëm në Rumani dhe as punojnë dhe as nuk krijojnë qarkullim jashtë Rumanisë.

ndërmarrjet mbi të cilat fitohet kontrolli nuk gjenerojnë asnjë qarkullim dhe nuk kanë ndërmarrje-bijë në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

#### **Udhëzim për mjetin juridik**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

**KRYETAR**  
**I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**  
**Prof. Dr. Владимир Наумовски**